

VACCINATION, A CRITICAL STEP TO GUARANTEE A HEALTHIER AND SAFER SOCIETY

Ariana Striniqi

University of Shkodra “Luigj Gurakuqi”, Shkodra, Albania, ariana.lacej@unishk.edu.al

Abstract: Have you ever wondered if we would have harmful germs everywhere, then why not get sick more often? The answer is that our body is very smart and has a lot of natural defenses against microbial attacks. This paper is not related to any curriculum, but will provide you with information on immunity. The presentation will be detailed and will illustrate how our body fights infection during the day, etc.

The control and prevention of infectious diseases relies on a thorough understanding of the factors that determine the transmission and mitigation of defense mechanisms. This article summarizes the basic principles of protection against these infectious diseases, while underlining the importance of immunization and vaccination.

The purpose is to inform people who are interested in reading it, in order to make themselves and others aware of the importance of the factors that influence the spread of diseases, lower immunity and overload of the body's protective factors. During this paper, various methods were used to provide accurate information to the audience, researching and requesting, in order to provide clear and valuable knowledge. Despite the results obtained from the questionnaires as well as the experience during the professional practice, I clearly document the great decline of vaccination. Accelerators will reflect and think longer about their discovery.

At the end of it, we will know that our body is very effective in maintaining health, we will be re-informed more about immunity, body protection and vaccination. We will also be absolutely vigilant about how to protect and take care of ourselves and others around us.

Keywords: Immunity, vaccination, maintaining health, prevention, infection

VAKSINIMI , NJË HAP KRITIK PËR TË GARANTUAR NJË SHOQËRI MË TË SHËNDETSHME DHE MË TË SIGURT

Ariana Striniqi

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shkodra, Albania, ariana.lacej@unishk.edu.al

Abstrakt: A keni menduar ndonjëherë se nëse mikrobet e dëmshme do t'i kishim kudo, atëherë pse nuk sëmuremi më shpesh? Përgjigja është se trupi ynë është shumë i mençur dhe ka shumë mbrojtje natyrore kundrejt sulmeve të mikrobeve. Ky punim nuk lidhet me ndonjë plan mësimor, por do t'ju ofrojë informata për imunitetin. Prezentimi do të jetë i hollësishëm dhe do të ilustrojë mënyrën se si trupi ynë e lufton infeksionin gjatë ditës, etj.

Kontrolli dhe parandalimi i sëmundjeve infektive mbështetet në një kuptim të plotë të faktorëve që përcaktojnë transmetimin dhe pakësimin e mekanizmave mbrojtës. Ky artikull përmbledh parimet themelore të mbrojtjes ndaj këtyre sëmundjeve infektive, ndërsa nënvizon rëndësinë e imunizimit dhe vaksinimit.

Qëllimi është që të informojmë personat që janë të interesuar ta lexojnë, në mënyrë që të ndërgjegjsojnë veten dhe të tjerët për rëndësinë e faktorëve që ndikojnë në përhapjen e sëmundjeve, uljen e imunitetit dhe mbingarkimin e faktorve mbrojtës të trupit . Gjatë këtij punimi janë përdorur metoda të ndryshme për të siguruar një informacion të saktë përpara audiencës, duke hulumtuar dhe kërkuar, në mënyrë që të japim dije të qarta dhe të vlefshme. Pavarësisht nga rezultatet e përfituara nga pyetsorët si dhe pvoja gjatë praktikës profesionale, dokumentoj qartazi rëndësinë e madhe të vaksinimit. Lezuesit do të reflektojnë dhe do të mendojnë më gjatë rreth zbulimit të tyre.

Në përfundim të tij, do të dijmë që trupi ynë është shumë efikas në ruajtjen e shëndetit , do të riinformohemi më shumë rreth imunitetit, mbrojtjes së trupit dhe vaksinimit. Absutisht dotë jemi vigjilent edhe se si të mbrohemi dhe të kujdesemi për veten tonë dhe të tjerët përreth.

Fjalë kyçe: Imuniteti, vaksinimi,shëndet,parandalim,infeksion

1. HYRJA

Ky punim është hartuar në përputhje me kurrikulën e fushës së shkencave të natyrës, kryesisht me lëndën e Biologjisë. Informacioni është i këndshëm, i përshtatshëm dhe i lehtë në përdorim sepse ka një terminologji të thjeshtë dhe të saktë. Pa dyshim, nxit përfshirjen e lexuesit në të, duke qënë se përmban të dhëna të dobishme për jetën e përditshme. Analizimi i tw dhwnave tw pyetwsorit kerkon tw nxjerrw pwrfundime pwr tw ndikuar nw sensibilizimin e tw rinjve lidhur me pajisjen me kartelat e vaksinimit ,si njw faktor i rwndwshishwm pwr ruajtjen e

shëndetit të tyre. Pa dyshim ai do të ndihmojë të rinjtë të kuptojnë rëndësinë e sistemit imunitar për të mbrojtur organizmin nga të gjithë agjentët e smundjeshkaktues. Cdo ditë ky sistem ndodhet përballë kësaj agjentëve dhe në sajë të aftësisë imunitare të tij, ai arrin të mbrojë organizmin, të mbrojë shëndetin.

Vaksinimi duke aktivizuar sistemin imunitar bën që trupi të jetë i gatshëm, në sajë të memorizimit të strukturës së agjentit të luftojë atë duke formuar antitropin përkatës.

Vaksinimi i rregullt në etapën kohore të përcaktuara shkencërisht luan një rol mjaft të rëndësishëm për të rritur aftësinë imunitare të organizmit duke ndikuar kështu në garantimin e një jetë të shëndetshme dhe rëndësishme të shoqërisë së sigurt.

2. MATERIALI DHE METODAT

Tema e hulumtimit është trajtuar nga aspekti teorik dhe empirik dhe nuk kërkon ndonjë metodologji empirike të avancuar. Metodologjia e përdorur i përmbanë këto elemente:

- Grumbullimin dhe përzgjedhjen e materialit (literaturës);
- Analizimin dhe strukturimin e materialit të grumbulluar dhe
- Përpunimin e materialit me të dhëna reale.

3. REZULTATET

Pyetja 1: Sa të informuar jeni rreth vaksinimit?



Analiza e pyetjes së parë tregon se një pjesë e madhe e gjimnazistëve kanë një informacion të pjesshëm lidhur me vaksinimin dhe rëndësinë e tij për shëndetin.

Pyetja 3: A mendoni se vaksinat janë të sigurta?



Vaksinimi për kampionin e marrë në konsideratë tregon se 51 % e shohin vaksinën si të sigurtë e ndërkohë 49 % e shohin atë si të pasigurtë. Nxënësit shprehin qartë se kanë dyshim në efektet e vaksinimit dhe në sigurinë e tij.

Pyetja 5 : A jeni vaksinuar rregullisht?




Pyetjes lidhur me rregullsinë e vaksinimit 80 % e të anketuarëve janë përgjigjur pozitivisht, 10 % negativisht dhe 10 % nuk jannë të qartë për këtë.

Pyetja 7 : A jeni te pajisur me kartelën e vaksinimit?



Kësaj pyetje 90 % janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa 10 % shprehen se nuk kanë kartelë vaskinimi

Pyetja 8 : A jeni vaksinuar me vaksinën e COVID-19?



71 % e të anketuarëve shprehen se nuk e kanë marrë vaksinën kundër COVID-19, kundërt 10 % ,të cilët i kanë marrë të dyja dozat, ndërkohë që vetëm 8 % shprehen se kanë marrë të dyja dozat.

Pyetja 11: A mendoni se vaksinat ulin vdekshmerine dhe semuendshmerine ne bote ?



Kesaj pyetje ,65 % e te anketuarëve janë përgjigjur se besojnë në rolin që kanë vaksinat në uljen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në botë,ndërkohë që 20 % nuk besojnë në rolin e vaksinave. Ndërsa 15 % shprehen “ Ndoshta”,pasi nuk janë të bindur në këtë rol të vaksinave.

4. DISKUTIME

1. Rritja e ndergjegjesimit te te rinjve per vaksinimin .
2. Informimi me te dhenat me te fundit te O.B.SH lidhur me rendesine qe ka marrja e vaksinave ne afate te percaktuara qarte .
- 3.Do te ishte mire qe te perdoreshin reklama sensibilizuese ku te vleresohej roli i vaksinave ne rritjen e aftesisë imunitare te organizmit .
4. Mesuesit krahas punes se tyre ne oren e mesimit per pervesimin e njohurive per imunitetin e vaksinimin ,te benin edhe pune sensibilizuese me te rinjte duke i bere te vetedijshem ata per rendesine e vaksinimit..
5. Perfaqesues te institucioneve shendetesore te organizonin takime me te rinjte per te diskutuar lidhur me imunitetin dhe vaksinimin.
- o. Informimi lidhur me afatet e realizimit te vaksinave ..

5. PERFUNDIME

Pavaresisht nga zhvillimi dramatik i dhjetëvjeçarëve,në trajtimin dhe parandalimin e tyre, sëmundjet infektive mbeten shkak më i madh i vdekjeve dhe sëmundshmërisë dhe janë përgjegjës për keqesimin e cilesisë së jetës së miliona njerëzve në botë. Proçeset infektive që duhen marrë në konsideratë për diagnozë diferenciale, paraqesin shpesh herë një sfidë për aftësitë diagnostikuese. Me lindjen e agjentëve antimikrobialë, ne duhet të besojmë që sëmundjet infektive së shpejti do eliminohen dhe do mbeten vetëm një interes historik. Vërtet,qindra agjentë kimioterapeutikë janë zbuluar gjatë gjithë kohërave. Shumica e tyre janë të fuqishëm e të sigurtë, përfshirë medikamentet e efektshme jo vetëm kundër bakterieve por gjithashtu kundër viruseve, kërpurdhave dhe parazitëve. Gjithësesi duhet pasur parasysh se kështu si kanë evoluar agjentët antimikrobiak po kështu janë zhvilluar dhe aftësitë e mikrobeve për të luftuar strategjitë tona më të mira dhe për të na kundërvepruar me strategji të reja duke siguruar mbijetesën e tyre. Rezistenca ndaj antibiotikëve ndodh në një përqindje alarmuese midis të gjitha llojeve të patogjenëve. Sëmundjet që dikur mendoheshin të çrrënjësura në vendet e industrializuara (tuberkulozi,kolera dhe ethja reumatizmale) sot , siç e pamë dhe më paraqesin rizgjim.

Agjentët infektivë dominantë të zbuluar kohët e fundit kanë rënë në kontakt me popullsinë lëvizjet e popullsisë dhe popullimit të kafshëve. Andaj njeriu nuk duhet të përpiqet të njohë vetëm botën që e rrethon, ai duhet dëshirojë dhe të kërkojë të dijë se si është përbërë dhe si funksionon vetë trupi i tij. Kjo gjë nuk u duhet njerëzve vetëm për të kënaqur dëshirën e tyre për të njohur, por sepse njohja e anatomisë dhe fiziologjisë janë të nevojshme për të ruajtur dhe forcuar shëndetin, për t'u mbrojtur dhe për të mjekuar sëmundjet. Pa këto njohuri, njerëzimi nuk do të kishte mundësi të zhdukte linë, murtajën dhe një sërë sëmundjesh të tjera të rrezikshme, nga të cilat, në të kaluarën, vdisnin me miliona njerëz.

Natyrisht, nuk mund të përshkruhen në mënyrë të plotë të gjitha proceset komplekse, të cilat ngjasin në organizmin tonë; këtu shumë gjëra janë lënë mënjanë. Sidoqoftë shumica e lexuesve do të kenë marrë disa njohuri mbi trupin dhe imunitetin e tyre, nga ky punim. Prandaj këtu ne folëm vetëm për disa të dhëna dhe ligje të sistemeve dhe qelizave të ndryshme të trupit të njeriut. Në paraqitjen e problemeve të shumta theksuam më tepër ato aspekte, të cilat do të ndihmojnë lexuesin të kuptojë bazën shkencore të porosive dhe këshillave për mbrojtjen e trupit që jepen në faqet e këtij punimi.

FALENDERIME

Falenderimi ka te beje me nxenesit e shkolles se mesme dhe mesuesit e tyre,te cilet pranuan qe te jepnin mendimet e tyre duke iu pergjigjur pyetjeve te pyetesorit.Shpresojme qe ky punim ti sherbeje si sensibilizim adoleshenteve,qe ato te formojne nje kulture te realizimit ne afatet e caktuara te vaksinave si nje faktor i rendesishem per rritjen e aftesisë imunitare te organizmave te tyre si dhe si kusht themelor per mireqenie te organizmit te tyre.

REFERENCAT

- Chlebowski, C. (2022). The Virus and the Host: Protect Yourself from Infectious Disease by Reducing Toxicity, Improving Immunity, and Minimizing Chronic Illness
- Franklin, M. (2019). Everything You Need to Know About Vaccines
- Greene, J. (2019). The Immunity Code: The New Paradigm for Immune Centric Health and Radical Anti-Aging.
- Hall E., Wodi P., Hamborsky J., Morelli V., & Schillie S., (2021). Epidemiology and Prevention of Vaccine-Preventable Diseases,Chapter 3 & 4
- Jones, M., & Jones, G. (2020). Biologjia 10-11, pjesa e I, 133
- Kline, D. (2023). “Vaccine” Injuries, Lies, and Deaths: The Alarming Facts About the Covid Vaccines and Helpful Resources for Healing
- Lahita, R. (2022). Immunity Strong: Boost Your Natural Healing Power and Live to 100
- Parham, P. (2021).The Immune System, Chapter 2
- Sompayrac, L. (2022). How the Immune System Works - 7th Edition
- Saxena, S. (2020). Coronavirus Disease 2019 (COVID-19): Epidemiology, Pathogenesis, Diagnosis, and Therapeutics (Medical Virology: From Pathogenesis to Disease Control)

Modeli i pyetësorit per nxenesit lidhur me vaksinimin

Sqarim për plotësimin e pyetësorit:

Përshëndetje! Ju jeni përzgjedhur për të dhënë mendimin tuaj duke plotësuar këtë pyetësor, i cili zgjat 10 minuta.

Qëllimi i pyetësorit është të mbledhë mendimet tuaja individuale në lidhje me pyetjet e mëposhtme. Përgjigjuni duke rrethuar ose duke vendosur x në pohimet e mëposhtme.

Ju sigurojmë se përgjigjet tuaja janë konfidenciale dhe anonime.

VAKSINIMI

1. Sa të informuar jeni rreth vaksinimit?
 - a. Aspak
 - b. Pak
 - c. Mjaftueshëm
 - d. Mjaftueshëm mire
 - e. Shumë mirë
2. A mendoni se vaksinat janë efektive?
 - a. Aspak
 - b. Pak
 - c. Mjaftueshëm
 - d. Mjaftueshëm mire
 - e. Shumë mirë
3. A mendoni se vaksinat janë të sigurta?
 - a. Po
 - b. Jo
4. A kanë vaksinat efekte anësore?
 - a. Aspak
 - b. Pak
 - c. Mjaftueshëm
 - d. Shumë
 - e. Nuk e di
5. A jeni të vaksinuar rregullisht?
 - a. Po
 - b. Jo
 - c. Nuk e di

6. A kanë funksionuar vaksiant tek ju?
 - a. Po
 - b. Jo
 - c. Nuk e di
7. A jeni të pajisur me kartelat e vaksinimit?
 - a. Po
 - b. Jo
 - c. Nuk e di
8. A jeni vaksinuar me vaksinën e Covid-19?
 - a. Po
 - b. Pjesërisht
 - c. Jo
9. Sa doza të kësaj vaksine keni marrë?
 - a. Asnjë
 - b. Një dozë
 - c. Dy doza
 - d. Tre doza
10. A mendoni se do ta bëni këtë vaksinë në të ardhmen?
 - a. E kam bërë
 - b. Besoj se po
 - c. Shpresoj
 - d. Kurrë
11. A mendoni se vaksinat ulin vdekshmërinë dhe sëmundshmërinë në botë?
 - a. Gjithmonë
 - b. Shpesh herë
 - c. Ndonjëherë
 - d. Rrallë
 - e. Asnjëherë

Procedura: Subjektet e përfshira në studim u kontaktuan nepermjet mesuesve të klasave perkatese. Aplikimi i pyetësoreve u realizua në një afat kohor 3 javor. Per plotesimin e pyetesorit ishte e nevojshme një kohe mesatare prej 5 minutash.

Ceshtje etike: Cdo subjekt i pyetur perpara se te plotesonte formularin eshte sqaruar dhe njohur me proceduren e kryerjes se tij nepermjet ketij paragrafi: Përshëndetje! Ju jeni përzgjedhur për të dhënë mendimin tuaj duke plotësuar këtë pyetësor. Qëllimi i pyetësorit është të mbledhë mendimet tuaja individuale në lidhje me pyetjet e mëposhtme. Përgjigjuni duke klikuar në pohimet e mëposhtme dhe pasi të jeni përgjigjur në fund klikoni submi